



Pranuar / Dorezuar Prijeno / Prodato Received / Delivered	27.06	2	viti god year
Organ / Njësia Org / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHUK	3761/2022		1/4



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.434/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Kocanëtarë si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.434/2022 të datës 29.04.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted] në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", kundër organit të punësimit Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 27.06.2022, mori këtë

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.434/2022 e datës 29.04.2022, e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. Shfuqizohet Vendimi me numër 703-2022 i datës 11.05.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komisionit Qendror Zgjedhor dhe Vendimi me numër 423-2022 i datës 11.03.2022 i Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- III. Obligohet Kryeshefi Ekzekutiv i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ti kompensoj ankuesit [redacted] ne mjete monetare dymbëdhjetë (12) ditë të pushimit vjetor të pashfrytëzuara të vitit 2021.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] sipas Vendimit të datës 07.06.2019 ka qenë i emëruar në pozitën "Drejtor Ekzekutiv" i Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim në Komisionin Qendror të

Zgjedhjeve, me status të nëpunësit civil, ndërsa sipas vendimit të nxjerr nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës me Nr.08-V-172 të datës 24.12.2012 i njëjti është zgjedhur Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Ankuesi me datë 29.01.2022 ka parashtruar kërkesën të Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për kompensimin e ditëve të pushimit vjetor të pa shfrytëzuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me Vendimin me numër 423-2022 të datës 11.03.2022 ka miratuar kërkesën e ankuesit lidhur me kompensimin e pushimit vjetor, për dhjetë (10) ditë pune për vitin 2020, dhe dymbëdhjetë (12) ditë pune për vitin 2021.

Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin me numër 423-2022 të datës 11.03.2022 të Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me datë 29.04.2022 parashtron ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 10.06.2022 ka nxjerr vendimin me numër VK.Nr.57/2022 për vazhdimin e afatit për vendimmarrje edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Ankuesi me datë 13.06.2022, ka përcjellë edhe provën shtesë lidhur me lëndën e tij konkretisht Vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke e kontestuar të njëjtin.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 12.05.2022 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Këshilli më datë 13.06.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/20.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:* Ankesa e ankuesit e datës 29.04.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me Nr.08-V-172 i datës 24.12.2021; E-mail i datës 29.01.2022, 14.02.2022, 01.02.2022, 31.12.2021, 31.03.2022; Vendimi i datës 11.03.2022; Vendimi i datës 07.06.2019; Vendimi i datës 29.12.2021 për bartjen e pushimit vjetor të vitit 2020; Kërkesa për pushim vjetor e datës 13.07.2021; Kërkesa për pushim vjetor e datës 20.10.2020; Kërkesa për pushim vjetor e datës 05.01.2021; Vendimi i datës 11.05.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është *e bazuar sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga provat e lëndës ka konstatuar se ankuesi me datë 14.02.2022 ka parashtruar kërkesën për kompensimin e ditëve të pushimit vjetor të pa shfrytëzuara tek Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Kryeshefi Ekzekutiv i Komisionit

Qendror Zgjedhor me datë 11.03.2022 nxjerr Vendim me numër 423/2022 me të cilën miratohet kompensimi i pushimit vjetor ndaj ankuesit për periudhën dhjetë (10) ditë pune për vitin 2020 dhe dymbëdhjetë (12) ditë pune për vitin 2021. Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin e datës 10.03.2022 të Kryeshefit Ekzekutiv të Komisionit Qendror Zgjedhor me datë 29.04.2022 parashtron ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komisionit Qendror Zgjedhor, i cili Komision me datë 11.05.2022 ka nxjerr vendimin me numër 703-2022 me të cilin është refuzuar ankesa e ankuesit dhe është vërtetuar vendimi i datës 10.03.2022 i Kryeshefit Ekzekutiv të Komisionit Qendror Zgjedhor.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se ankuesi me datë 29.04.2022 ka parashtron ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendim ankimor kundër Vendimit Nr.423/2022 të Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor, dhe se me datë 13.06.2022 i njëjti ka plotësuar ankesën duke kundërshtuar edhe Vendimin me numër 703-2022 të datës 11.05.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili ka kërkuar që të ndryshohet Vendimi i Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor me numër 423-2022 duke i shtuar edhe dymbëdhjetë (12) ditët e mbetura te vitit 2021 në vendimin për kompensim të ditëve të pushimit vjetor të pashfrytëzuar, Kolegji ka analizuar dispozitat e *nenit 85 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës* ku është përcaktuar se *„Ndërprerja e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, me vendim të njëanshëm bëhet kur institucioni ose nëpunësi civil merr iniciativë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. 2. Marrëdhënia e punës në shërbimin civil ndërpritet me vendim të njëanshëm në rast të: 2.1. dorëheqjes dhe shkarkimit nga shërbimi civil për arsytet e parapara me këtë lig” si dhe dispozitat e nenit 5 paragrafin 8 të Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë* ku është përcaktuar se: *“Në rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, nëpunësi civil kompensohet me pagesë të kalkuluar për ditët e pashfrytëzuara të pushimit vjetor. Në rastin e kundërt, nëse ditët e pushimit vjetor janë shfrytëzuar para kohës së fitimit të drejtës për pushim, atëherë nga paga e fundit bëhen ndalesat e kalkuluara për ditët e pa fituara”*, andaj ne rastin konkret Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke u bazuar në këto dispozitat ligjore si dhe dëshmime të ofruara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankuesi me Vendim me Nr.08-V-172 të datës 24.12.2012 është emëruar Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsion nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ndërsa me datë 31.12.2021 ka ofruar dorëheqje nga pozita “Drejtor Ekzekutiv” i Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, çka nënkupton se ankuesit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, po ashtu bazuar në përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit te cilët kanë theksuar se: *“Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) ne vitin 2021, kishte dy procese zgjedhore, Zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare, të cilat u mbajtën me datën 14 shkurt 2021 dhe zgjedhjet lokale të mbajtura me 17 tetor 2021. Për arsye të aktiviteteve në proces zgjedhor dhe volumit tejet të madh të punës në këto procese zgjedhore, stafi i Sekretariatit të KQZ, e kishte të pamundur shfrytëzimin e pushimit vjetor 2020,...”*, Kolegji konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit është i qëndrueshëm, dhe se kompensimi i pushimit vjetor ankuesit i takon në kuptim të nenit 5 paragrafi 8 të Rregullores Nr.06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë, dhe nenit 6 paragrafi 8 të Udhëzimit Administrativ (KQZ) Nr.01/2018 për Pushimet e Stafit të Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor.

Andaj, bazuar ne faktet e lartcekura, pasi që ankuesit sipas Vendimit me numër 423-2022 të datës 11.03.2022 të Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i janë kompensuar në mjete monetare ditët e pushimit vjetor të pashfrytëzuara, konkretisht dhjetë (10) ditë pune për vitin 2020 dhe dymbëdhjetë (12) ditë pune për vitin 2021, prej gjithsejtë tridhjetekatër (34) ditëve të pushimit vjetor të pashfrytëzuara, sipas të dhënave të Zyrës se Burimeve Njerëzore, andaj Kolegji konstaton se Kryeshefi Ekzekutiv i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është i obliguar që ankuesit ti kompensoj ne mjete monetare edhe dymbëdhjetë (12) ditët e mbetura të pushimit të pashfrytëzuara të vitit 2021 nga dita e pranimit të këtij vendimi, të cilat me Vendimin me numër 654-2022 të datës 10.05.2022 të Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i janë lejuar të barten në vitin 2022.

Kolegji, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 703-2022 të datës 11.05.2022, nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, duke vepruar kështu ne kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën Administrative, Rregulloren Nr.06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civil, dhe Udhëzimit Administrativ (KQZ) Nr.01/2018 për Pushimet e Stafit të Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit të Kryetares së Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.434/2022

Valentina Kaçandolli Belkteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsorë GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- Udhëheqëses së Personelit në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.

